

Përfaqësuesi Special i BE-së në Kosovë

Fjalimi i mbajtur nga Pieter Feith, Përfaqësuesi Special i BE-së në Kosovë
në Konferencën e Donatorëve për Kosovën - Bruksel

E premte 11 korrik 2008

Kryeministër, Komisioner, të nderuar përfaqësues të komunitetit donator
ndërkombëtar,

- Jam i lumtur që marr pjesë në këtë konferencë të shumëpritur dhe të shumë-nevojitur donatorësh për Kosovën në kapacitetin tim si Përfaqësues Special i Bashkimit Evropian për Kosovën. Posaçërisht për arsye se kjo konferencë po mbahet në kontekstin e angazhimit në rritje të BE-së për të përkrahur progresin në Kosovë.
- Do të desha të falenderoj në veçanti Komisionin Evropian për organizimin dhe mikpritjen e kësaj ngjarjeje këtu në Bruksel.
- Ndhima ndërkombëtare duhet të përqendrohet në krijimin dhe zhvillimin e strukturave të qëndrueshme që sigurojnë parashikueshmëri dhe stabilitet dhe si rezultat shtrojnë rrugën për zhvillim në Kosovë. Kjo është shumë e rëndësishme në çdo ekonomi. Në Kosovë ndikimi potencial i suksesit, apo dështimit, i kalon për së tepërmi masat e zakonshme dhe do të jetë jetësor për një të ardhme stabile dhe paqësore. Zhvillimi ekonomik jo vetëm që do të rrisë prosperitetin por gjithashtu do të zbusë tensionet politike.

For further details:

Office of the European Union Special Representative (EUSR)
Tel: + 381 (0) 38 2044 - 307 (office) + 377 (0) 44 509 760 (mobile) E-mail:
julia.rueter@eusrinkosovo.eu
www.eusrinkosovo.eu

- Konferenca e donatorëve, dhe përcjellja e saj, do të forcojë themelet e dinamizmit ekonomik. Zhvillimi ekonomik i Kosovës ka mbetur mbrapa fqinjëve të saj. Për shkak të dekadave të neglizhencës në investime publike, Kosovës do t'i nevojitet përkrahje financiare për vitet dhe gjeneratën e ardhshme.
- Megjithatë synimi jonë duhet të jetë që ta shkurtojmë këtë periudhë sa më shumë që të jetë e mundur. Stabiliteti dhe parashikueshmëria në rritje do të jenë kyçe për suksesin e Kosovës. Në mënyrë që Kosova të shkojë drejt një mjedisi të qëndrueshëm aq sa duhet për të tërhequr investimet dhe për të garantuar të drejta të barabarta për të gjithë banorët, unë do të desha të identifikoja tre fusha me përparësi: i) forcimin e sundimit të ligjit, ii) decentralizimin me të mirat e tij për komunitetin serb të Kosovës, dhe iii) reformën në sektorin e sigurisë duke përfshirë krijimin e institucioneve të reja.
- Progresi në këto fusha do të na ndihmojë që t'i afrohem një Kosovë shumetnike stabile me kushte të përmirësuara sociale dhe ekonomike për të gjithë qytetarët.
- Pa harruar kërkesën e madhe në të gjithë Kosovën, përpjekje të veçanta duhet të bëhen për të përmirësuar situatën për komunitetin serb. Mjeti i përgjithshëm duhet të jetë decentralizimi. Megjithatë, ky është një proces i gjatë dhe ne duhet ta ndihmojmë qeverinë në Prishtinë që të mbërrijë te komuniteti serb tani. Nuk kemi kohë për të humbur. Për këtë arsye unë duhet të theksoj nevojën për projekte të menjëhershme që synojnë përmirësimin e standardit të jetesës në zonat serbe.
- Bashkimi Evropian është i gatshëm ta përkrahë qeverinë në udhëheqjen e implementimit të reformave të nevojshme nëpërmjet angazhimit të tij të trefishtë. Komisioni Evropian do të luajë një rol kyç nëpërmjet asistencës së tij të vazhdueshme teknike dhe financiare për ta përkrahur Kosovën në përmbushjen e kushteve të nevojshme për progres të mëtejshëm në procesin e integritimit evropian. Në anën tjetër, EULEX-i, misioni më i madh i Politikës Evropiane për Siguri dhe Mbrojtje në historinë e BE-së do të ofrojë përkrahje më të madhe në forcimin e sundimit të ligjit, si një aspekt kyç për zhvillim të suksesshëm. Së fundmi, zyra ime do të vazhdojë të ofrojë koordinimin, përkrahjen dhe këshillimin e nevojshëm politik.

For further details:

Office of the European Union Special Representative (EUSR)
 Tel: + 381 (0) 38 2044 - 307 (office) + 377 (0) 44 509 760 (mobile) E-mail:
julia.rueter@eusrinkosovo.eu
www.eusrinkosovo.eu

- Në fund unë do të desha të përgëzoj qeverinë për cilësinë e lartë teknike të kornizës së saj afat-mesme. Me sa kam kuptuar nga njerëzit që kam takuar, kosovarët kanë vullnetin dhe iniciativën që t'i përdorin si duhet mjetet e premtuara sot.

Ju uroj fat të gjithëve për konferencën e frytshme dhe ju falenderoj shumë për vëmendjen tuaj.

For further details:

Office of the European Union Special Representative (EUSR)
Tel: + 381 (0) 38 2044 - 307 (office) + 377 (0) 44 509 760 (mobile) E-mail:
julia.rueter@eusrinkosovo.eu
www.eusrinkosovo.eu